



Republika e Kosovë
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pratmatja	Referenca Me Datë	Adresa	Vlera
Nr. Dokumenti	Nomenklatura	Adresa	Vlera
07	170/05-488		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 4, 5 dhe 6 të Rregullorës Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjen e Komunave në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, Rregullorës (QRK) Nr.19/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullorës Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrjen e Komunave në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.04.2026, miraton këtë:

V E N D I M

për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Qëllimi i themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL)

1. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave dhe aseteve publike përmes ofrimit të shërbimeve publike cilësore dhe efikase në Komunën e Vitisë.
2. Kursimi i taksave të qytetarëve që shkojnë për pagesën e shërbimeve që ofrojnë operatorët ekonomik privat.
3. Rritja e përgjegjesisë dhe transparencës gjatë ofrimit të shërbimeve publike.
4. Zgjerimi i shërbimeve, dhe përmirësimi i tyre, që i ofrohen qytetarëve të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL)

1. Menaxhimi i Stacionit të Autobusëve,
2. Menaxhimi i tregjeve,
3. Menaxhimi i parkingjeve publike,
4. Mirëmbajtja e hapësirave publike, shesheve e parqeve,
5. Mirëmbajtja e objekteve publike,
6. Mirëmbajtja dhe pastrimi i shtretërve të lumenjëve,
7. Mirëmbajtja e varrezave dhe shërbimet e varrimit,
8. Menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave,
9. Përgjegjësi tjera që ndërlidhen me shërbimet publike.

3.a. Shërbimet publike që aktualisht Komuna i kryen përmes kontraktimit të operatorëve ekonomik privat përfshinë pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe

kanalizimit, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave. dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së;
3. Zyrës së kryetarit
4. Drejtoris për shërbime Publike dhe Emergjencë
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi

